



Iniciativa për të Dhëna të Hapura në Kosovë

BULETIN

01

SHUKRT
2019

Çka janë të dhënat e hapura?

Të dhënat të hapura janë ato të dhëna të cilat vihen në dispozicion në formë digjitale, në një format që mundëson përpunimin e tyre kompjuterik ('machine-readable'), dhe që mund të përdoren, ripërdoren, shpërndahen, kudo dhe për çfarëdo qëllimi si dhe nga çdo kush pa kufizime që rrjedhin nga të drejtat e autorit, patentat apo mekanizma të tjerë të kontrollit.

Cilat janë përfitimet me hapjen e të dhënave?

Hapja e të dhënave ndikon pozitivisht në efikasitetin dhe përmirësimin e administratës publike si dhe mbështet rritjen ekonomike të sektorit privat. Krahas kësaj hapja e të dhënave ndryshon për të mirë mënyrën se si qeveria, biznesi dhe shoqëria komunikojnë dhe funksionojnë. Të dhënat e hapura gjenerojnë njohuri si dhe inovacion, dhe janë thelbësore për qeverisje të mirë, transparente dhe llogaridhënese. Hapja e të dhënave ndihmon pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje si dhe krijon mundësi të reja për të kontribuar në adresimin e sfidave sociale e ekonomike në vend.



“Hapja e të Dhënave është në përputhje me vizionin tonë dhe obligimin kushtetues që kemi për qeverisje të mirë, transparente dhe llogaridhënese. Hapja e të dhënave ka përfitime të shumta si për proceset demokratike, por po ashtu edhe për zhvillimin ekonomik dhe inovacionin.”

Ministri Mahir Yağcılar
Ministria e Administratës Publike

Miratohet vendimi për themelimin dhe funksionimin e strukturave për iniciativën për të dhëna të hapura

15 Janar 2019

Zyra e Kryeministrit të Kosovës ka aprovuar propozimin e Ministrisë së Administratës Publike (MAP) për themelimin dhe funksionimin e strukturave për iniciativën për të dhëna të hapura. Ky vendim paraqet një moment kyç në përpjekjet e MAP për të avancuar iniciativën për të dhëna të hapura.

Vendimi nr. 05/84 parasheh krijimin e një Grupi Drejtues për të dhëna të hapura nën udhëheqjen e Ministrit të MAP dhe me pjesëmarrjen e sekretarëve të përgjithshëm nga disa ministri dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile. Koordinator i iniciativës për të

dhëna të hapura caktohet Drejtori i Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit (ASHI), brenda së cilës krijohet një Njësi për të Dhëna të Hapura. Vendimi po ashtu parasheh krijimin e Grupit Punues për të Dhëna të Hapura për koordinimin e zbatimit të planit të veprimit për të dhëna të hapura. Grupi Punues do të përfshinë përfaqësues nga të gjitha ministrinë dhe agjencitë, të emëruar si persona kyç për hapjen e të dhënave. Vendimi obligon të gjitha ministrinë dhe agjencitë në varësi të Qeverisë të hapin të dhënat e tyre në përputhje me interesin publik dhe të i publikojnë ato në portalin kombëtar për të dhëna të hapura.

ASHI lançon një portal të ri për të dhëna të hapura

ASHI ka lansuar portalin e freskuar dhe të ridizajnuar për të dhëna të hapura, me qëllim që të jetë më lehtë i përdorshëm dhe i qasshëm nga ana e qytetarëve. Portali i ri përmban një sërë përmirësimesh dhe plotësimesh, për shembull, ofron funksione të reja dhe një dizajn të azhurnuar që maksimizon ato funksione si dhe përmirëson eksperiencën e përdoruesve.

Gjej të Dhënat e Hapura të Qeverisë së Kosovës

Pa qendër të dhënave të hapura të Kosovës është një platformë digjitale që ofron akses të hapur dhe të qartë të të dhënave të hapura të Kosovës dhe të përdoren në mënyrë të hapur.

050
SETI I TË DHËNAVE
006
ORGANIZATA ME TË DHËNA

Kategoritë

Të dhënat e publikuara janë rezultat i bashkëpunimit të bashkimit të shteteve të Kosovës me bashkëpunuesit dhe partnerët e tyre të huaj.

Qeveria dhe Sektori Publik	Artet, Kultura dhe Sporti	Biznesi
Mbrojtja e mjedisit	Ekonomia dhe Financa	Shkencat dhe Shkencat
Shëndeti	Popullsia dhe Demografia	Bujqëria
Transporti dhe Infrastruktura	Shkencat dhe Teknologji	Publik

Të dhënat me popullaritet

Qëllimi i këtyre të dhënave është të ofrojnë informacione për popullaritetin e të dhënave të hapura të Kosovës dhe të përdoren në mënyrë të hapur.

Përditësimi i fundit i të dhënave

Qëllimi i këtyre të dhënave është të ofrojnë informacione për datën e fundit të përditësimit të të dhënave të hapura të Kosovës dhe të përdoren në mënyrë të hapur.

opendata.rks-gov.net


Iniciativa për të Dhëna të Hapura në Kosovë



Publikimi i Raporti i Vlerësimit të Gatishmërisë për Hapjen e të Dhënave – ODRA

6 Nëntor 2018

Me rastin e finalizimit të Raportit të Vlerësimit të Gatishmërisë për Hapjen e të Dhënave – ODRA, Ministria e Administratës Publike (MAP) organizoi një konferencë me përfaqësues nga institucionet publike dhe shoqëria civile, për të diskutuar të gjeturat e këtij raporti. Në konferencë u prezantua vlerësimi i raportit se Republika e Kosovës ka një bazë solide dhe një klimë tanimë të favorshme politike për zhvillimin e një iniciative efektive për hapje të të dhënave. Aty po ashtu u theksua se Raporti ODRA nxori një Plan të



Veprimit për hapjen e të dhënave që propozon aktivitete afat-mesme dhe afat-gjate, në mesin e të cilave, si aktivitet primar, parashihej krijimi i kornizës së nevojshme institucionale për zbatimin e politikave për hapjen e të dhënave në Kosovë. Ky aktivitet, aktualisht është duke u realizuar.

Në konferencë prezantoi edhe ish-shefja e njësisë për të dhëna të hapura në Bankën Botërore, znj. Amparo Ballivián e cila tha se vlerëson lartë përpjekjet e qeverisë së Kosovës për të promovuar të dhëna të hapura duke vlerësuar se publikimi i raportit të ODRA është një hap i rëndësishëm në drejtimin e duhur. Vlen theksuar se Banka Botërore po ashtu ka qenë e përfshirë në procesin e përgatitjes së ODRA-s duke bërë rishikimin e raportit për të ofruar komente.

Punëtori për hapjen e të dhënave me qëllim zhvillimin e kapaciteteve dhe mobilizimin institucional

7 nëntor 2018

Ministria e Administratës Publike në bashkëpunim me OJQ-ODK organizuan punëtori me përfaqësues të institucioneve të Qeverisë së Kosovës OJQ-ve, komunitetit të biznesit, mediave, institucioneve akademike, etj., me qëllim që të ketë një mobilizim të shtuar nga ana e qeverisë për hapjen e të dhënave. Punëtorja është fokusuar në eksplorimin e nevojave për prioritizim të publikimit të grupeve të të dhënave qeveritare apo 'data-seteve' që bartin më së shumti potencial për të realizuar përfitime nga hapja e tyre. Punëtorja po ashtu pati ndikim në vetëdijesimin e të pranishmëve mbi metodologjinë, rëndësinë dhe ndikimin pozitiv të hapjes së të dhënave si dhe të bashkëpunimit të midis zyrtarëve të institucioneve publike me shoqërinë civile dhe komunitetin e biznesit. Punëtorja është drejtuar nga znj. Amparo Ballivián, eksperte e të dhënave të hapura dhe ish-shefe e Njësitit për të Dhënat e Hapura në Bankën Botërore.

Projekti i MAP për Reformën e Administratës Publike: MAP është duke zbatuar një numër aktivitete të një rëndësie të veçantë për hapjen e të dhënave të Qeverisë në sja të projektit dy-vjeçar të titulluar 'Mbështetje për Zbatimin e Reformës së Administratës Publike'. Projekti financohet nga Qeveria e Kosovës dhe përfundon së zbatuar në Maj të vitit 2019. Projekti po zbatohet nga CPM (Letonia) dhe NOVUS (Kosova).

Publikohen të dhënat për gjendjen e shërbimit civil

11 janar 2018

Ministria e Administratës Publike (MAP) për herë të parë publikon të dhënat për gjendjen në shërbimin civil të Republikës së Kosovës përmes 80 tabelave në kuadër të 19 data-seteve në portalin kombëtar për të dhëna të hapura.

Publikohen të dhënat për masat disiplinore në shërbimin civil

5 gusht 2018

Ministria e Administratës Publike (MAP) publikon në portalin kombëtar për të dhëna të hapura të dhënat për masat disiplinore ndaj shërbyesve civil për keqpërdorim të detyrës zyrtare dhe shkelje të kordit të mirësjelljes gjatë vitit 2017.

DISA PREJ ZHVILLIMEVE KRYESORE NË INICIATIVËN PËR HAPJEN E TË DHËNAVE

Fillimi i procesit të inventarizimit të të dhënave në qeverinë e Kosovës

24 Janar 2018

Në kuadër të përmbushjes së procesit të hapjes së të dhënave të qeverisë, lindi nevoja për të inventarizuar të dhënat që prodhohen nga ministritë dhe agjencitë në Kosovë. Për këtë arsye, MAP ftoi një punëtorë për të diskutuar iniciativën për Hapjen e të Dhënave, me fokus në inventarizimin e tyre.

Pjesëmarrës të këtij takimi ishin zyrtarët për komunikim me publikun të Ministrive të linjës. Në këtë punëtorë, Agjencia për Shoqërinë e të Dhënave (ASHI) udhëzoi këta zyrtarë në atë se si të realizohet inventarizimi i të dhënave dhe u kërkoi secilit institucion që të i përgjigjet përpjekjeve për inventarizimin e të dhënave që zotojnë në institucionet përkatëse.



Shkurt-Mars 2018

Gjatë muajve Shkurt dhe Mars, u realizuan një numër i vizitave trajnuese nga ekipi i përbërë nga përfaqësuesit e ASHI si dhe nga ekspertët e projektit të MAP. Këto takime u realizuan në pothuajse të gjitha ministritë, me ç 'rast u synua auditimi i llojeve të seteve të të dhënave që këto ministri prodhojnë gjatë funksionimit të

11 prill 2018

Ministria e Administratës Publike mbajti edhe një punëtorë me përfaqësues të ministrive të nivelit qendror për të diskutuar progresin në procesin e inventarizimit të të dhënave dhe për të adresuar sfidat dhe shqetësimet e paraqitura gjatë këtij procesi. **Rreth 60% e ministrive, dorëzuan një draft listë të të gjitha 'data-seteve' që këto ministri**

Adresimi i kuadrit ligjor për të dhëna të hapura

Tetor, 2017 – Qershor, 2018

Me kërkesën e Zyrës së Kryeministrit në Kosovë, Ministria e Administratës Publike ofroi mbështetje në hartimin e **Ligjit të ri për Qasje në Dokumente Publike (LQDP)**. Në përputhje me principet e cekura në Kartën për të Dhëna të Hapura dhe praktikat më të mira, drafti i ri i këtij ligji përmban një kapitull të veçantë për Hapjen e të Dhënave (kapitulli III).

Me 23 korrik 2018, Kuvendi i Kosovës ka kaluar në shqyrtimin e parë LQDP-në dhe aktualisht është duke u trajtuar nga komisionet e përkatëse të Kuvendit para se të nxirret për aprovim final.

DISA PREJ ZHVILLIMEVE KRYESORE NË INICIATIVËN PËR HAPJEN E TË DHËNAVE

MAP fillon procesin e Vlerësimit të Gatishmërisë për Hapjen e të Dhënave

22 nëntor 2017

Nën udhëheqjen e Ministrit Yağcilar, përmes një konference për shtyp, MAP inicioi procesin për Vlerësimin e Gatishmërisë për Hapjen e të Dhënave në Kosovë – **ODRA (Open Data Readiness Assessment)**, duke u bazuar në metodologjinë e Bankës Botërore. Qëllimi i ODRA-s është realizimi i një skenimi të hollësishëm të kapaciteteve, mundësive dhe të sfidave në fushën e hapjes së të dhënave, në mënyrë që të përgatiten intervenime efektive prej anës së qeverisë duke kujtuar se sektori publik prodhon dhe mbledh një gamë të gjerë të dhënash dhe informacione të cilat duhet të bëhen të përdorshme për publikun.

Vlerësimi konsiston në një seri intervistash me palët e interesuara duke përfshirë këtu zyrtarë qeveritarë por edhe palë të pa asociuar me institucionet qeveritare, rishikimin e dokumenteve strategjike dhe raporteve relevante si dhe kornizës ligjore ekzistuese



dhe mbulon tetë dimensione studimi. Duhet theksuar se Shoqëria Civile dhe akterë të tjerë të fushës së teknologjisë së informacionit janë konsultuar po ashtu.

Si pjesë e këtij procesi, Ministri organizoi një takim punues me përfaqësues nga institucionet qendrore të Qeverisë, si dhe shoqërinë civile me qëllim të informimit me detajet e planit për vlerësimin e gatishmërisë për hapjen e të dhënave në Kosovë.

Filet e Iniciativës për Hapjen e të Dhënave

Me 13 maj të vitit 2016 Qeveria e Republikës së Kosovës me **Vendimin nr. 07/87** miraton **Kartën për Hapjen e të Dhënave**. Ky vendim mundëson krijimin e portalit të parë kombëtarë për të dhëna të hapura dhe cakton Agjencinë për Shoqëri të Informacionit (ASHI) përgjegjëse për administrimin e portalit si dhe ngarkon Ministrinë e Administratës Publike (MAP) të udhëheq iniciativën për hapjen e të dhënave.

Vendimi bazohet në principet kryesore të Kartës për Hapjen e të Dhënave e cila argumenton se ndërtimi i një shoqërie prosperuese, të barabartë dhe të drejtë kërkon që qeveritë të jenë transparente dhe llogaridhënese dhe të kenë angazhim kuptimplotë me qytetarët. Të gjitha institucionet obligohen të hapin, njëherit publikojnë të dhënat e tyre në këtë portal.

Dimensionet e studimit në ODRA

- Lidhshipin e Nivelit të lartë
- Korniza e Politikave/Ligjore
- Strukturat Institucionale, Përgjegjësitë dhe Kapacitetet e Qeverisë
- Politikat, Procedurat për Menaxhimin e të Dhënave Qeveritare, Disponueshmëria e të Dhënave
- Kërkesa për të Dhënat e Hapura
- Angazhimi dhe Kapacitetet e Shoqërisë Civile për të Dhënat e Hapura
- Financimi i Programit për të Dhënat të Hapura
- Infrastruktura Kombëtare e Teknologjisë dhe e Shkathtësive

Gjashtë parimet kryesore të Kartës për të Dhëna të Hapura

- Të dhënat duhet të hapen në mënyrë pro-aktive
- Të publikohen me kohë dhe të jenë gjithëpërfshirëse
- Të jenë lehtë të qasshme dhe të përdorshme
- Të jenë të krahasueshme dhe ndërvepruese
- Të shërbejnë për të përmirësuar qeverisjen dhe pjesëmarrjen qytetare
- Të nxisin inovacionin dhe përfshirjen në zhvillim.